



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 23.04.2013, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Jemin Gjana – kryetar komisioni

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për burimet e energjisë së rinovueshme”.

Marrin pjesë:

Jemin Gjana, Osman Metalla, Ilir Bano, Ardian Turku, Bedri Hoxha, Blendi Klosi, Sybi Hida, Selami Xhepa, Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Artan Gaçi, Besnik Dushaj, Ismail Hoxha dhe Ramiz Çobaj.

Mungojnë:

Dashamir Tahiri, Aurel Bylykbashi Kreshnik Çipi, Arjon Muçaj, Rrahim Çota, Hazir Gashi, Ndreç Dedaj, Ndue Kola, Anduel Xhindi dhe Sadri Abazi.

Të ftuar:

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Energjisë në METE.

Zija Kamberi - përfaqësues i METE-s.

HAPET MBLEDHJA

Jemin Gjani - Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sipas kalendarit sot do të fillojmë shqyrtimin e projektligjit “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, i cili është një ligj i ri integral. Kemi rënë dakord që zoti Bano të jetë relator.

Po, zoti Bano.

Illir Bano – Me anë të këtij projektligji synohet të krijohet baza e plotë ligjore për promovimin e shfrytëzimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme.

Në të parashikohet të forcohet skema e mbështetjes për këtë lloj energjie dhe të garantohet përputhshmëria me legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian.

Më konkretisht në nenet e projektligjit përcaktohen:

a- detyrimi për hartimin e planit kombëtar të veprimit për energjinë e rinovueshme, si edhe skemat mbështetëse për të nxitur prodhuesit e energjisë elektrike nga këto burime, në këtë kuadër do të krijohet edhe Fondi Kombëtar për Energjinë e Rinovueshme;

b- lehtësohen procedurat e licencimit dhe i jepet përparësi lidhjes në sistemet e rrjetit të energjisë elektrike;

c- parashikohet detyrimi për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar prej burimeve të energjisë së rinovueshme, për ata prodhues që do të përfitojnë prej tarifës së futjes së energjisë në rrjet;

d- vendosen rregulla të qarta e transparente për llogaritjen e tarifës së futjes së energjisë elektrike në rrjet, duke krijuar kështu një klimë besimi te investitorët;

e- promovon sistemet e paneleve diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë në ndërtesat publike dhe private;

f- jep parashikime të qarta lidhur me të drejtat, detyrimet dhe përfitimet e të gjithë pjesëmarrësve të tregut shqiptar të energjisë elektrike.

Në projektligj trajtohen edhe çështje të tjera, për shembull përcaktohet Agjencia e Burimeve Natyrore si institucioni përgjegjës për burimet e rinovueshme të energjisë, si edhe saktësohen dhe jepen detyra shtesë për entin e energjisë.

Në përgjithësi projekti është hartuar në përputhje me detyrimet tona dhe marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Mendoj se ky projekt duhet të miratohet nga komisioni dhe më pas nga seanca plenare.

Jemin Gjana - Po, zoti Bregasi.

Agim Bregasi - Sikurse e përmendi edhe zoti Bano, ky është një ligj i plotë për sa i përket shfrytëzimit të burimeve të energjive të rinovueshme, me të cilat Shqipëria është fatmirësisht e pasur si në burimet ujore, ato të energjisë së diellit, të erës, si edhe energji të tjera.

Në hartimin e këtij projekti ne jemi asistuar nga specialistë të huaj. Jemi konsultuar me Sekretariatën e Komitetit të Energjisë në Vjenë, me të gjithë aktorët që kanë ndikim te ky ligj. Me grupet e interesit janë bërë seanca dëgjimore.

Ne mendojmë se në këtë ligj janë reflektuar jo vetëm direktivat e BE-së, për sa u përket energjive të rinovueshme, por edhe marrëdhëniet konkrete në territorin shqiptar, duke mos devijuar aspak nga direktivat e BE-së, sepse presupozohet të mos ketë ndërhyrje thelbësore në të ardhmen, por vetëm nëse ato diktohen nga direktivat e BE-së. Ka një përputhje pothuajse të plotë me direktivat e BE-së dhe me të gjitha rregullat e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë.

Qëllimi i këtij ligji ishte që të kishim një ligj të plotë integral, për stimulimin e energjive të rinovueshme, në mënyrë që investitorët qoftë vendas apo të huaj, të kenë një dokument të plotë të cilit t'i referohen për të investuar në energjitë e rinovueshme. Në ligjin ekzistues "Për sektorin e energjisë" ka dy nene për këtë gjë, por këtu është elaboruar plotësisht me hollësi dhe në detaje. Shumë nga çështjet janë lënë të zgjidhen me akte të tjera, si me vendime të Këshillit të Ministrave, vendime të Entit Rregullator apo udhëzime të ndryshme të ministrit përkatës i cili është përgjegjës për energjinë. Ajo që ka rëndësi në këtë ligj, përveç përputhjes me direktivat e BE-së, është fakti se me të synohen të nxiten investimet në shfrytëzimin e energjive të rinovueshme, me qëllim që të realizojmë edhe treguesin që e kemi si detyrim nga BE-ja për të realizuar në fund të vitit 2020, atë prej 38% të përdorimit të energjive të rinovueshme te konsumatori fundor. Ky është një vendim i cili është marrë pas studimeve të ndryshme që janë bërë si nga sekretariati, por edhe nga pala jonë me asistencë të huaj. Ai është miratuar në tetor të vitit 2012 nga këshilli ministror i Traktatit të Energjisë. Në këtë ligj, gjejmë zgjidhje të gjitha shqetësimet e investitorëve se si mund të procedohet për të aplikuar një objekt që shfrytëzon energjinë e rinovueshme, cilat janë procedurat dhe fazat, si edhe cilat janë incentivat që sigurohen. Në ligj, për të garantuar më shumë investitorët dhe për transparencë, është parashikuar edhe një formulë që llogarit se sa do të jetë çmimi final i energjive të rinovueshme për ata që do të përfitojnë një tarifë fikse. Ne kemi përcaktuar, në analogji edhe me hidrocentralet që janë ndërtuar deri tani në zbatim të ligjit "Për koncesionet", që deri në 15 megavat, të kemi

incentiva, në mënyrë që edhe për përdorime private dhe të vogla të burimeve të rinovueshme, sidomos të energjisë së diellit dhe të erës, të jepen mundësi dhe lehtësira në procedura, në mënyrë që të jenë të interesuar vetë përdoruesit, banorët, por edhe investitorët, që të prodhojnë panele të ngrohjes së ujit, si edhe të parqeve të vogla me erë, në mënyrë që të kemi një shfrytëzim sa më maksimal, por në kushte optimale të këtyre energjive me të cilat vendi ynë është i pasur.

Formula merr parasysh teknologjitë, një kosto mesatare të investimit të këtyre teknologjive në vitet e fundit dhe një çmim mestar që do të shitet tri vitet e fundit. Parashikohet që Enti Rregullator, në zbatim të kësaj formule, çdo tre vjet duhet të rishikojë tarifat me të cilat do të futen dhe do të publikohen me qëllim që investitori të dijë se sa do të jetë çmimi që do t'i blihet energjia elektrike. Në ligj është bërë një përcaktim. Burimet gjeneruese ndahen në dy kategori: në ato me përparësi dhe ato të zakonshme. Ato me përparësi kemi menduar të jeni deri në 15 megavat dhe të kenë disa avantazhe, jo vetëm në procedurat e licencimit dhe dhënies së autorizimeve për ndërtimin e tyre, por edhe në aksesin që do të kenë në rrjetet e transmetimit. Sipas ligjit dhe direktivës, ato do të kenë përparësi për t'u lidhur në rrjet dhe për të transmetuar energjinë elektrike që do të prodhohet nga këto impiante për në rrjetin shpërndarës apo atë të transmetimit.

Në projekt parashikohen edhe marrëdhëniet midis operatorëve të ndryshëm ku bëhet matja, si edhe çështje teknike që do t'i shikojmë nen për nen.

Në fund parashikohet që Këshilli i Ministrave dhe Enti Rregullator, sipas teknikës legislative, nene dhe pika të caktuara, të nxjerrin aktet dhe vendimet e tyre.

Kjo ishte shkurtimisht përmbajtja e ligjit, cili ishte qëllimi i tij, si mendohet të realizohet ky qëllim me incentivat që jep dhe plotësimet me akte të tjera nënligjore.

Jemin Gjajana – Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Padyshim përbën një gjë pozitive, që edhe kuadri ligjor pavarësisht sa zbatohet, të jetë në vendin e duhur deri sa të krijohen strukturat apo ndjeshmëritë që të respektojmë dhe ligjet në Shqipëri.

Unë kam një shqetësim në lidhje me përdorimin e energjisë së rinovueshme. Nëse kemi të bëjmë me burime natyrore që kanë status të veçantë dhe janë monumente natyre, a ka prioritet në këtë rast ruajtja e këtyre vlerave apo ndërtimi qoftë edhe i një hidrocentrali të vogël që

shkakton një impakt të konsiderueshëm në mjedis, në raport me burimin energjetik që ofron? Cili është qëndrimi juaj?

Jemin Gjana – Po, zoti Bregasi.

Agim Bregasi - Pyetja është shumë me vend, pasi përbën një shqetësim për të cilin ne kemi nënshkruar dhe është pikë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë që jo vetëm kërkon sigurimin e furnizimit me energji elektrike, por një nga pikat është edhe ruajtja e mjedisit. Në praktikën e deritanishme për dhënien me koncesion të hidrocentraleve, një nga dokumentet që duhet të dorëzohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore është edhe studimi mjedisor që parashikon se ku kalon, çfarë efektesh ka, a ka dëmtime dhe probleme jo vetëm me monumentet natyrore, por edhe në zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme qoftë për kalimin e shpendëve, kanione dhe monumente të tjera. Në dokumentacion është një material i veçantë për mbrojtjen e mjedisit dhe çdo aplikues duhet të ketë marrë nga agjencia përkatëse e mjedisit në rrethe, por edhe nga Ministria e Mjedisit, lejen për të ushtruar aktivitetin në një zonë të caktuar e cila është e përcaktuar me koordinata të sakta. Sa vjen aplikimi, ai dërgohet në Ministrinë e Mjedisit me koordinata dhe thuhet: “Ju lutemi, kërkojmë mendimin tuja për investimin e këtij karakteri”. Mund të jetë mulli me erë, burim uhor apo me diell, nëse prek ndonjë pjesë që atakon ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”. Po kështu merret edhe për monumentet e kulturës. Ka pasur raste kur i është sugjeruar subjektit që të shmanget nga pozicioni në të cilin kanë bërë propozimin e parë.

Jemin Gjana - Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj - Me thënë të drejtën, do të doja shumë të ishte kështu, por realiteti shqiptar kontraston në mënyrë të jashtëzakonshme me të gjitha këto fjalë që thatë ju dhe në përgjithësi me ato që ofron ligji. Arsyeja është shumë e thjeshtë se, kur interesat politike të qarqeve dhe klaneve të caktuara futen në lojë, ato nuk pyesin as për ligj, as për rregull dhe as për vlerësim të impaktit në mjedis. Rasti është shumë konkret, për hidrocentralin e Langaricës në Përmet që është një kanion dhe ka shumë e shumë të tjerë, por nuk pyetet fare. Bëhen ndërhyrje të cilat në mënyrë të padiskutueshme dëmtojnë mjedisin, kur komuniteti nuk është dakord për ndërtimin e tyre, por ne nuk duam t’ia dimë pavarësisht se jemi pjesë e Konventës së Aarhus-it. Të gjitha këto që thatë ju janë shumë të bukura, por nuk janë për Shqipërinë. Të gjitha këto që adoptojmë janë për Bashkimin Europian, por jo për Shqipërinë. Kjo për mua është drama, në përgjithësi e shoqërisë shqiptare, që ne gënjejmë veten. Ne dukemi sikur po ua hedhim të huajve,

por ne ia hedhim vetes sonë. Të huajt vijnë këtu, sugjerojnë, pastaj largohen. Ata që pësojnë jemi ne vetë. Ka një agresivitet në drejtim të burimeve natyrore, sepse konsiderohen si pronë pa pronarë, pronë socialiste si të thuash, pra siç veprimej dikur para viteve '90. Dëmet janë të jashtëzakonshme. Po kështu është në Langaricë apo në hidrocentralet që mund të mos kenë këtë lloj statusi. Por detyrimet ligjore që kanë këto subjekte private për të rehabilituar mjedisin janë zero. Në një hidrocentral në Fterrë ndërhyrja është zero. Kur shkon e sheh, gjen një situatë dramatike dhe thua se këta vetëm njerëz nuk janë. Por sigurisht nuk është detyra e tyre, është e jona, si ligjvënës, ekzekutivi në nivel pushteti lokal ose qendror që të mbajmë qëndrimin e duhur. Me thënë të drejtën unë nuk besoj atyre që thonë ju, pavarësisht se janë shumë të bukura, sepse deri tani nuk janë zbatuar asnjëherë.

Jemin Gjana – Kush ka pyetje të tjera?

Eduard Shalsi – Ka pasur disa projekte të deklaruara në lidhje me shfrytëzimin e energjisë së rinovueshme. Unë doja të dija, çfarë ndodhte me këto projekte në mungesë të ligjit? Tani që ka hyrë ligji në fuqi, çfarë do të ndodhë me ato projekte të deklaruara, duke filluar që nga parqet eolike të Karaburunit e deri te ato të Lezhës dhe Shkodrës? Pra raportin e ligjit me projektet ekzistuese. Në çfarë niveli janë? Mbjaj mend se në negociatat e vitit 2008, një grup i fuqishëm investitorësh italianë kërkonte të dinte edhe projektet e qeverisë në lidhje me legjislacionin, pra si afektohen. Çfarë pritet të sjellë ky ligj në lidhje me investimet në këtë fushë? Pra, cila është pritshmëria në qoftë se do të mblidhemi edhe pas 6 muajsh, 1 viti ose 2 vjetësh? Çfarë pret qeveria, cilado qoftë ajo?

Jemin Gjana – Ka pyetje të tjera? Po, zoti Gaçi.

Artan Gaçi – Pyetjet e mia ndoshta nuk kanë shumë lidhje me ligjin, por do të desha të di, a ka bllokime për këto dy lloj projektesh, që do të shtjelloj më poshtë?

E para, me sa kam dijeni, në disa vende energjia prodhohet edhe nga prodhues të vegjël privatë, të cilët pastaj e shkëmbejnë në rrjet me sahatet me dy kahe, që vetëprodhojnë energji, që mund të jenë minicentrale ose minisisteme diellore, edhe private, siç është rasti i Gjermanisë ose i Kalifornisë, por kur kanë tepriçë konsumi, i kthehet rrjetit. A është e parashikuar në ligj ose a e zhbllokton këtë sektor edhe në këtë pikë?

E dyta, shoh që është rritur interesimi i investitorëve që prodhojnë panele diellore dhe sisteme solare, të cilët kërkojnë, ka pasur raste edhe në Shqipëri, kam kontaktuar rastësisht me disa prej tyre, të lidhin kontrata me ente publike, siç mund të jenë shkollat ose spitalet, për të

ndërtuar të gjithë fasadën ose çatinë me panele diellore, duke arritur deri aty sa pagesa e këtij sistemi t'i bëhet në bazë të faturës elektrike. Pra, në vend që të paguash faturën elektrike, paguan faturën të këta investitorë. A është e mundur nga ana ligjore që kur një investitor i fuqishëm strategjik të vijë nesër dhe të lidhë kontratë, për shembull, me spitalet ose me shkollat shqiptare, të bëjë investimin ose ta shlyejë atë? A e parashikon ky ligj këtë rast?

Jemin Gjana – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Në fakt, unë kisha për të shtruar një çështje, megjithëse duhet t'u hysh llogaritjeve dhe nuk kemi kohë, për përcaktimin e kësaj formule dhe detyrimit për entin rregullator për të përcaktuar një herë në 3 vjet.

Pyetja ime e parë, në fakt u shtrua me të drejtë edhe nga zoti Shalsi, a do të përfshijë edhe burime energjetike të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji?

A aplikohet kjo formulë edhe tek të tjerët?

A rrezikon ta ngurtësojë çështjen e vendimmarrjes së ERE-së një formulë e futur të ligji?

Të gjithë jemi të prirë për të krijuar hapësira dhe lehtësira për burimet e rinovueshme të energjisë. Duhet të pranojmë se, megjithëse jemi vend mesdhetar, përveç se në burimet e energjisë bazuar tek uji, në burimet e energjisë bazuar tek era dhe veçanërisht të diellit jemi prapa. Shumë vende të tjera kanë përparësi të mëdha. Madje edhe vendet e Europës së Veriut që i kanë më të kursyera se në orët e diellit.

Shqetësimi që ka kolegu Baraj qëndron, por qëndron jo në ligjin në vetvete sesa në zbatimin e tij. Unë mendoj që ligji është për t'u parë nëse kemi ndonjë gjë për të ndryshuar apo përmirësuar. Zbatimi i tij, si edhe në shumë raste të tjera, është një problem tjetër. Nuk duhet të dëmtojmë një gjë, të cilën nuk e riparojmë dot kurrë më, për efekt të një burimi energjie që mund ta ndërtojmë diku tjetër.

Ka pyetje të tjera?

Marrim përgjigjet e pyetjeve.

Agim Bregasi – Për sa i përket pyetjeve të zotit Shalsi, nëse ka pasur projekte të tjera të deklaruar, sidomos ai i Vlorës dhe i Shëngjinit, në mungesë të ligjit çfarë ka ndodhur, çfarë është bërë deri tani, si afektohen këto me ligjin që kemi, po ju them se dy objektet kanë status tjetër. Mund të them, megjithëse nuk është detyra e ardhjes time këtu, se ata kanë qenë të mbështetura në ligj. Në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike" janë bërë amendime të nevojshme. Në atë kohë, siç jeni informuar edhe ju, pasi është kaluar në parlament, hap pas hapi,

në varësi të zhvillimit të sektorit energjetik në Shqipëri, të ndarjes së KESH-it në tre kompani, të stimulimit të ndërtimeve të objekteve të tjera gjeneruese qoftë atyre që janë me koncesion, por edhe atyre që nuk janë, është parashikuar edhe ndërtimi i centraleve me erë, si funksionon certifikata e origjinës, si funksionon certifikata jeshile, por që të jemi realistë deri tani nuk ka përfunduar asnjë pakt me erë. Mendojmë se kuadri ligjor në atë kohë nuk e pengonte zhvillimin e parqeve me erë. Ligji që kemi sjellë rregullon të gjitha marrëdhëniet midis të gjithë aktorëve dhe është në përputhje, pothuajse të plotë, me direktivat e BE-së. Ne presim që ky ligj të sjellë atë që investitori të gjejë në një paketë të gjithë kuadrin ligjor për të investuar në Shqipëri në këtë drejtim, sidomos të stimulojmë burime edhe më të vogla, qoftë në ambiente publike apo edhe në ambiente private, si në hotele. Pra, me këtë ligj presim të stimulojmë investitorët e huaj dhe vendas për të përdorur panelet diellore për prodhimin e energjisë termike dhe elektrike, në mënyrë që të çlirojmë rrjetin e energjisë elektrike nga humbjet që mund të ketë për të vajtur deri në zonat e largëta apo në zonat malore. Në këtë mënyrë i japim një shtysë edhe implementimit, sidomos në zonat turistike të largëta malore, por edhe në zonat bregdetare që të çlirojmë përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje që përdorim deri tani. Në ligj është parashikuar që Këshilli i Ministrave me aktet e veta të miratojë specifikisht për grupe banesash apo konsumatorësh kriteret të veçanta se si do të implementohen, çfarë përfitimesh do të kenë dhe si do të jenë marrëdhëniet mes palëve. Në fillim thashë se ne me këtë ligj përpiqemi të stimulojmë investimet për impiante të vogla më praktike në Shqipëri dhe që janë më të prekshme nga konsumatori fundor.

Për sa i përket energjisë elektrike që prodhohet, natyrisht që parashikohet të zgjidhet i njëjti sistem si në Europë me matës që regjistron energjinë që kemi marrë nga rrjeti. Në momentin kur ka teprica, e kalon në rrjet dhe bëhet diferenca. Kundrejt entit të shpërndarjes ose të furnizimit me energji elektrike paguan vetëm diferencën e energjisë, pra pikërisht atë që ke marrë nga rrjeti. Tepricat i kalon në rrjet. Natyrisht në qoftë se ke lënë më shumë, në ligj i lihet kompetencë Këshillit të Ministrave. Përveç kësaj në ligjin “Për sektorin e energjisë”, që ne e kemi çuar në Këshillin e Ministrave, ka një përkufizim, një nen ku futen edhe ata që quhen vetprodhues, pra prodhon për vete, kurse tepricën mund të kthejë në rrjet dhe aty përcaktohen edhe marrëdhëniet. Pra, në fund të fundit, ajo që ne kërkojmë të realizojmë me ligjin “Për sektorin e energjisë”, që është zhveshur realisht nga kapitujt ose nenet që kishin për energjinë e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë, është e bërë me strukturor nga pikëpamja organizative,

nga detyrimet, që parlamenti, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse e me radhë, është që të stimulojmë, për mendimin tim, sidomos investimet jo shumë të mëdha dhe jo vetëm për t'i rregulluar këto marrëdhënie, por që të kenë akses në rrjet për t'u futur dhe për të transmetuar energjinë. Gjithashtu edhe për të blerë tepricat kundrejt formulës, siç u shpreh edhe zoti Gjana.

Për sa i përket bllokimit të investimeve, natyrisht që mund të ketë faktorë të ndryshëm, sepse shpesh vijnë investitorë dhe ankohen në instanca më të larta, duke pretenduar se kanë aplikuar që në këtë datë e në atë kohë. Por po të shikosh dokumentacionin, ai është jo i plotë në disa raste. Në vendimin e qeverisë nr. 1701, datë 17 dhjetor 2008, ka një pikë që thotë: “Në qoftë se dokumentacioni nuk është i plotë, ai nuk quhet se ka aplikuar”, pra aplikimi konsiderohet i rregullt, kur ai ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin. Megjithatë them se ky ligj, ku investitorët gjejnë gjithçka, jo të hallakaten sa në një ligj, te një vendim qeverie, do të jetë shumë stimulus për ata.

Për sa i përket formulës që thotë zoti Gjana, ne këtë e kemi bërë me asistencë të BERZH-it. Kemi një material të plotë, rreth 200 faqe, në të cilin analizohen zgjidhjet në vende të ndryshme të Europës e më gjerë, ku për kushtet tona do të jetë më e përshtatshme kjo formulë. Aty parashikohet sesi do të jetë kostoja për teknologji të ndryshme, pra për ujin, erën, diellin e të tjera, për një periudhë 3-vjeçare, ku mendohet se nuk do të ketë lëvizje të teknologjive shumë të mëdha, por risku është i atij që hyn i pari apo i dyti. E rëndësishme për investitorin është se çmimi i caktuar me këtë formulë do t'i vazhdojë për një afat të gjatë, është parashikuar deri në 15 vjet, pastaj varet nga dëshira e tij. Në qoftë se dëshironi, ne mund të sjellim edhe shembuj se ku është përdorur kjo formulë, por për kushtet tona, na është rekomanduar dhe ne pas shumë diskutimeve e kemi pranuar këtë formulë. E kemi futur edhe në ligj që investitori ta dijë se energjia që prodhon do të jetë me këtë çmim për një afat të përcaktuar që në fillim të kontratës. Për atë që vjen pas 3 vjetësh apo 5 vjetësh është Enti Rregullator, që bën apejtimin e këtyre tarifave apo ndryshimeve të kostove, që kanë ndodhur në pajisjet, makineritë që duhen për të ndërtuar një objekt, qoftë edhe në çmimin me të cilin shitet në treg apo te privati, ose marrëdhëniet që do të ketë ai me privatin.

Jemin Gjana – Faleminderit!

Kush ka komente?

Eduard Shalsi – Ju thatë se ky ligj është bërë me ndihmën e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, apo është vetëm formula?

(Diskutim pa mikrofon.)

E ke në ligj formulën? Dakord. Atëherë, ju thoni se është bërë me IFC-në? Sa kohë ka që punohet me këtë ligj?

Agim Bregasi - Ideja jonë ishte që të punohej paralelisht me ligjin “Për sektorin e energjisë” dhe ashtu u bë. Ligji “Për sektorin e energjisë” është bërë me asistencë të USAID-it dhe ligji që po prezantojmë këtu është bërë me asistencë të IFC-së, në mënyrë që të kishim një përputhje të plotë në përkufizime dhe në idetë e trajtimin të të gjitha problemeve. Të mos kishim mbivendosje, ose kundërshtime, ose boshllëqe të mundshme për sektorin që nuk ishin parashikuar. Përveç kësaj edhe BE-ja ka bërë amendime të direktivës së energjive të rinovueshme dhe jemi përpjekur që në këtë ligj të gjejmë një zbatim të plotë të direktivave të BE-së. Kjo është situata.

Eduard Shalsi – Më 30 shtator të vitit 2012 duhet të raportoni për planin kombëtar të energjisë së rinovueshme. Apo jo? Me sa shikoj, edhe te kapitulli i dytë i ligjit nuk është marrë mundimi që të rishikohet. Ky ligj qëndron nëpër sirtarë. Brenda datës 30 shtator të çdo viti, duke filluar nga viti 2012, Ministria duhet t’i paraqesë Kuvendit të Shqipërisë planin kombëtar të veprimit të përpunimit për burimet e rinovueshme. Çfarë ndodh me planin kombëtar? Do të bëhet në bazë të ligjit, apo po punohet paralelisht edhe me planin kombëtar dhe me agjencinë?

Agim Bregasi - Mund të them se si ky ligj dhe plani kombëtar i veprimeve janë punuar paralelisht. Edhe plani i veprimeve është realizuar si draft. Mund të them se në muajin tetor të vitit 2012 u miratua treguesi i energjive të rinovueshme që duhet të realizojë Shqipëria deri në vitin 2020. Pra, në mbledhjen e Këshillit Ministror të Sekretariatit të Vjenës, mbajtur në tetor, është miratuar treguesi. Është lënë detyrë që edhe në planin e veprimit të futet dhe ne po bëjmë apdejtimin edhe të planit kombëtar të veprimit. Pra, është punuar paralelisht. Pra, edhe në planin e veprimit, edhe me këtë.

Jemin Gjajana – Ajo çka sollët në vëmendje, zoti Shalsi, deri më sot nuk kemi trajtuar asnjëherë një ligj të veçantë, të posaçëm, për energji të rinovueshme. Ka pasur ndërhyrje te ligji “Për sektorin e energjisë”, kapitull më vete, tek i cili ne kemi bërë dy herë ndryshime. Kemi bërë përmirësime, por është hera e parë që diskutojmë për një ligj integral të shkëputur nga ligji “Për sektorin e energjisë”, i cili është një ligj për energjitë e rinovueshme.

(Diskutime pa mikrofon.)

Agim Bregasi - Unë jam përfaqësues i ministrisë për këtë ligj dhe po diskutojmë për këtë ligj. Në qoftë se ju kërkoni diçka më shumë, ne mund t'ju sjellim një informacion të statusit të projekteve për energjitë e ERE-s.

Eduard Shalsi –Kur fillove sqarimin, pikasa një fjali, që shpresoj të ketë qenë e nxituar dhe jo e qëllimshme, sepse thatë “se nuk është detyrë”. Ne si ligjvënës kemi një përgjegjësi shumë të madhe: për këto gjëra që miratojmë duhet të dimë se çfarë është e bëshme dhe cila jo. Pyetjet tona kanë lidhje me aplikimin e këtij ligji. Kemi një eksperiencë të hidhur jo të këtyre viteve, por vazhdimisht gjatë tranzicionit, që miratojmë ligje të mira, ndërkohë që nuk shërbejnë për asgjë në praktikë. Ne duam të sigurohemi, nga eksperiencat e kaluara, se çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë jo, në mënyrë që të mos përsërisim gabimet e së kaluarës, ose të nxjerrim disa mësim nga e kaluara. Qëllimi i pyetjeve këtë gjë synon, për të kuptuar se ka qenë çështje ligji, ka qenë çështje incentivash, ka qenë çështje regjimi taksash, ka qenë problem dielli, ka qenë problem fizik, shpirtëror apo material? Çfarë problemi ka qenë?

Këto janë pyetjet që ne u drejtojmë titullarëve të institucioneve. Thjesht dhe vetëm për të kuptuar se ky ligj që miratojmë u shërben apo jo në praktikë njerëzve. Ndaj, detyrat tuaja janë të na qartësoni, të na kthjelloni sa më shumë, që edhe ne të marrim një vendimmarrje sa më të drejtë.

Jemin Gjana – Kush do të diskutojë? Ka komente të tjera?

Jemi dakord ta miratojmë në parim? Kush është dakord? Dakord. Faleminderit!

Nesër në orën 11:00 do të mbledhemi për miratimin e projektligjit nen për nen.

Ju lutem, njoftoni kolegët të mos mungojnë.

Mbledhja mbyllet.

Mirupafshim!

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretar

Osman Metalla

Përgjegjëse e komisioneve parlamentare

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Valbona Miho